Zbulim i mistershëm arkeologjik: Illyricum Sacrum nuk mund të quhet Ylli i Davidit!

Ndalohet publikimi pa lejen e autorit dhe të botuesit. Të interesuarit shqiptarë dhe të huaj mund të marrin adresën e kontaktit të Autorit nga redaksia. Kujdes: zagarët e Serbisë të quajtur Polici e Kosovës ma përgjojnë telefonin për një kohë shumë të gjatë!

Isa Mulaj

Përmbledhje

Artefakti dhe eksponati më i rëndësishëm arkeologjik i gjetur në Kosovë mbetet "Hyjnesha në Fron", një statujë e argjilës me madhësi 18 centimetra. Është gjetur në rrethin e Prishtinës. Llogaritet se është e vjetër përafërsisht 5.500 vite dhe ka qenë vepër e ilirëve, fisit të dardanëve që ka banuar në atë rajon. Forma e kësaj statuje është shfrytëzuar për ta krijuar stemën e Komunës së Prishtinës që përdoret edhe sot si simbol zyrtar. Se sa e rëndësishme është "Hyjnesha në fron" dhe çfarë domethënie ka, nuk është ndonjë pyetje që ka ndikim në të tashmen dhe të ardhmen, pos asaj se është një fakt që dëshmon se aty ka ekzistuar një civilizim antik i fisit të dardanëve me të cilët shqiptarët e sotëm nuk kanë lidhje trashëgimore të afërta por të largëta, si për shembull polakët dhe sllovenët në kuadër të sllavëve. Në këtë punim të cilin po e paraqesim në formë shumë të shkurtuar dhe me të dhëna sipërfaqësore për shkak të rëndësisë së jashtëzakonshme që ka zbulimi në të cilin bazohet, sjellim dëshmi arkeologjike nga terreni për të ashtuquajturin Yllin e Davidit, Lulen e Jetës, dhe Pemën e Jetës të gjetura së bashku në një guri të gdhendur mermeri të madhësisë 1 metër të gjatë, dhe 30 centimetra të gjerë në të gjitha anët. Pas analizave, vjetërsia e gurit është përafërsisht 4.000 vjetër? Është gjendur në vendin **4248'41.50"V,** është guri i mermerit, i marrë nga shkëmbi aty çka vërtetohet edhe me praninë e gurëve tjerë me përbërje të njëjtë të pagdhendur, dhe është gdhendur aty ku është nxjerrë si lëndë e parë**.** Çka do të thotë ky guri, dhe çka mund të kthej shumëçka mbrapshtë rreth disa gjërave dhe simboleve që e dimë se kanë ekzistuar dhe sot përdoren shumë ? Punimin e plotë do ta gjeni në librin me titull: "E vërteta historike dhe origjinaliteti si mollë e ndaluar: pasojat e censurës, indoktrinimit dhe propagandës komuniste – një qasje ontologjike dhe epistemologjike".

Fjalët kyçe: Illyricum Sacrum, Shushica, Ylli i "Davidit", Lulja e Jetës, Pema e Jetës.

Hyrje

Ky punim nuk paraqitet në formën standarde të shkruar, por në formë të prezantimit dhe me ilustrime.

Dihet se:

- Dielli ka qenë simboli më i përhapur dhe objekti më i adhuruar në natyrë në paganizëm.
- Kryqi është simbol pagan që është adaptuar si simbol i krishterimit. Të krishterët nuk e mohojnë këtë fakt.
- Kryqi i thyer (swastika) nuk ishte simbol ekskluziv i nazistëve. Është me origjinë nga indasit e lashtë (që nuk kanë asgjë të përbashkët me indianët e sotëm), e mund të jetë edhe me origjinë ilire sepse e kanë përdorur edhe këta.
- Ylli i "Davidit", i hasur kudo nëpër kisha, xhamia, sinagoga, varre, dhe rajone të ndryshme gjeografike deri edhe në Kinë, nuk është fare i Davidit. Davidi nuk ka jetuar para 4.000 viteve. Atëherë, pse ky yll shfaqet në Shushicë, dhe a e kanë vjedhur si simbol hebrenjtë?
- Ylli pesëcepësh shpesh herë në popull ishte identifikuar si simbol i komunizmit. Dihet se ylli i tillë nuk është simbol i komunizmit dhe e përdorin të gjithë popujt.
- Çdo tendencë ose synim për ta lidhur Yllin e "Davidit" me Mburojën (Stemën) e Davidit që përmendet te Psalmet 3:3 në Bibël është trillim, sepse nuk dihet çfarë ishte ajo stemë.
- Ylli gjashtëcepësh është adaptuar si simbol i judaizmit dhe hebrenjve vetëm prej shekullit XVII e këndej, njësoj sikur ylli pesëcepësh për komunizmin prej shekullit XX. Hebrenjët, siç e konstaton autori hebre Shlomo Sand në librin e tij të përkthyer në shqip me titullin "Si u sajua (shpif) kombi çifut" nuk janë as racë, as religjion, e as komb, por më tepër ideologji.
- Deri më sot, gjersa pranohet se kryqi nuk është pronë e të krishterëve, "swastika" e nazistëve, ylli pesëcepësh i komunizmit, duhet qartësuar punën e Yllit të "Davidit" sepse jemi duke u përballuar me fakte nga terreni.

Çka tregon zbulimi arkeologjik nga Dukagjini Verior?

Po filloj me “Gishtat e Mujë Halilit” në Kërrsh të Vogël, por nuk po u tregoj se çka thotë legjenda rreth tyre. Shikoni fotografinë e mëposhtme:



Fotografia 1: “Gishtat e Mujë Halilit”

Fotografia 2: Autori te “Gishtat e Mujë Halilit”

Kjo “evidencë” mund ta nxisë Shoqatën e Arkeologëve Evropianë ta quajnë këtë që e shohin si “mashtrim i mizershëm”, term që e kishin përdorur kundër pretendimeve të arkeologut boshnjak Semir Osmanagiq se disa kodra në Visoko të Bosnjës janë piramida gjigante të ndërtuara para 12.000 viteve. Shoqata e Arkeologëve Evropianë lëshoj një deklaratë ku dënoheshin gërmimet rreth atyre vendeve, dhe e njoftoj publikun se e tëra është dukuri natyrore pa asnjë shenjë të veprimtarisë njerëzore. Mua nuk më intereson se a janë ato piramida të ndërtuara nga njerëzit apo kodra të formuara nga natyra. Nëse juve u intereson, shkoni e gërmoni vetë atje. Unë po u sjelli këtë në vijim nga Shushica:

Ylli i Davidi kurrë nuk ka qenë dhe nuk është i Davidit

Fotografia 3: Illiricum Sacrum: Lulja e Jetës, Pema e Jetës, Ylli i "Davidit" në mes me "Syrin e Masonëve" brenda në gjashtë këndesh

A është kjo vepër e nënës apo babës natyrë? A është ky "mashtrim mizor"? Apo, mos e kam marrë diku nga interneti? Shikoni fotografinë e radhës:

Fotografia 4: A po e njihni këtë njeri në fotografi?

Fotografia 5: Autori me Illyricum Sacrum

Ka edhe gurë tjerë aty që nuk po i bëjë publik për shkak se disa shqiptarë më kanë dalë shumë të pabesë. Kishin pas punuar shumë për të ma vjedhur ose përndryshe për të ma dhe sabotuar punën. Kjo është arsyeja pse unë kam vendosur ta ndaloj punën "krrup", dhe ta mbaj top sekret për momentin rreth dy gurëve të ngjashëm që gjenden diku në perimetrin prej 4 kilometrave nga vendi ku e kam gjetur këtë që duket në fotografi. Vendi i përafërt i ndodhjes së tyre është lokalizuar dhe ata (gurët) mund të gjenden të mbuluar me dhè. Kjo ka ndodhur para nja 20 viteve (hedhja dhe groposja e tyre). Metodën e zbulimit të tyre e kam të gatshme, por nuk do ta bëjë të njohur kurrë derisa të hasi në njerëz të besueshëm për t'i bërë hulumtimet, gërmimet, dhe analizat. Kur e kam gjetur "Illyricum Sacrumin", nuk e dija se kujt t'i tregoj që ta mbaj pak fshehtë. Ia dërgova një fotografi (këtë ulur mbi guri, fotografinë 4 më lartë) kushëririt tim Rifatit dhe e pyeta se si të veprojmë. Ndonëse e luta ta mbajë për vete dhe sekret, ai e kishte shpërndarë masovikisht dhe u kishte treguar shumicës së Istogut pa dijeninë time, pra në formë sekrete. Fotografinë 4 e kishte zmadhuar dhe shtypur me ngjyra në formatin A4. Një fletë të shtypur me ngjyra po ma jap mua. Një tjetër më tha se ia kishte dhënë Enver Boletinit. Menjëherë e thirri me telefon Enverin për t'i treguar se unë isha aty! Bisedoj me të dhe insistoj me ngulm të bisedoj edhe unë, sado që refuzova se mund të takohemi të nesërmen, por bërtiste "kape (telefonin celular të tij), kape, kape!" U dasht të bisedoj sepse nuk e dija kush është Enveri dhe mos po krijonte bindjen se çfarë njerëzish ishim unë e Rifati që po grindeshim

rreth një telefonate. I thashë Enverit se vijmë nesër. Të nesërmen kushëriri e kishte sjellë Enverin në shtëpi të tij. Aty e gjeta. Filloj presioni i kushëririt:

- Trego ku gjendet guri e t'shkojmë te vizitojmë me Enverin!
- Kadale, se guri nuk ik askund, aty mbetet, ka kohë, shkojmë tjetër ditë se sot është vonë, ora 3. Plus jam i zënë rreth përgatitjeve për një simpozium që do të mbahet në Stamboll. E vizitojmë po sa të kthehemi, iu përgjigja.
- O s'ki qare pa kallu, se përndryshe nuk je kusheri i jemi!
- A me qare e keni ba, a? Pritni kur t'kthehna prej Stambollit.

Rifati u bë nervoz se donte ta shihte gurin para se të kthehej në Berlin. Kishte bërë përpjekje për ta gjetur vendin në bazë të fotografisë 4, dhe kishte kërkuar konsulencë të gjithanshme se ku mund të jetë bërë fotografia 4. Disa herë më ka pyetur dhe nuk i kam treguar, gjersa nuk isha në dijeni rreth përpjekjeve të tij. I supozonte edhe vendet duke m'i përmendur, dhe i thoja: "Qasajde dikah!" Hipëm në xhip të tij me Dukagjin Rexhën, fqinjit e tij të parë. Kur qe, edhe Dukagjini menjëherë e merr llafin e gurit! Euuu! "S'paska mbet njeri në Istog që nuk qenka informuar për këtë guri", i thash Dukagjinit, ndërsa ky i indoktrinuar me historinë e rrejshme të shqiptarëve, thoshte: "Moti e kanë marrë vesh këtë punë." Edhe ky asi shqiptari siç i kishte përshkruar Karl Marksi shqiptarët në përgjithësi, insistonte me nervozë t'ia tregoj vendin e gurit.

Pasi kthehem nga Stambolli, Shaban Uça (fqinj i Rifatit dhe Dukagjinit) më ndal në Istog dhe më tregon se si Rifati dhe Enveri kanë kërkuar shumë ton ditën e lume nëpër përrua, gardhiqe, stomit t'prronit e përgjatë shelgjeve për gjetjen e gurit deri sa u kishte dalë gjuha përjashta! E dija fort mirë se ishin në ekspeditë për gjetjen e gurit, por nuk e kam menduar se do të shpenzojnë kaq mund të madh që ma përshkroi Shabani. Shabani më përgëzoj qe nuk u kam treguar, dhe më tha se duhet me ta qit një kafe për këtë. Unë i thashë se ti e meriton një drekë prej meje jo pse më tregova sepse edhe ashtu e dija qëllimin e tyre në prapavijë, por vetëm se e ke këtë bindje se puna në besim nuk duhet tradhtuar për interesat e të tjerëve në kurriz timin. Meqenëse isha për ngut, i premtova Shabanit të qëndroj andej pari nesër se do të vij dhe kemi kohë për kafe e për drekë. Në përmbyllje i tregova Shabanit këta istogasit për këtë punë të madhe me rëndësi përtej Kosovës janë askushi, prandaj ky konspiracion është poshtërimi më i tmerrshëm që po më bëhej. Dhe pas bisedës me Shabanin, dy gurët tjerë në lokalitet tjetër që mund të jenë dëshmi edhe më të mira si ky që po e paraqes, do të "mrizojnë" dhe nuk do të zbulohen. Vetëm kur të dua unë ata kanë për t'u zbuluar. Kushdo mund të nisë ekspeditën për gjetjen e tyre derisa t'u del gjuha nga mundi duke kërkuar! Mund të filloni edhe të boni hajgare si istogasit e hupt! Por ta dini vetëm një gjë: se këto artefakte, duke mos përfshirë edhe dy gurët tjerë që për shkaqe objektive do të bllokohen "krrup", nuk janë "cerrtana" ose "buggs bunny" sikur ajo "Hyjnesha në Fron" që nuk do të thotë gjë kush e di se çka, por fakte që mund

ta tronditin botën. Prandaj, ai/ajo që e ndien veten pjesë e trashëgimisë dhe shkencëtar i vërtetë, duhet t'i denoncoj ashpër istogasit e hupt, e pse jo edhe shumicën e institucioneve të Kosovës të cilat nuk e kemi edhe krejt kot e kot, por të dëmshme.

Po ua paraqes edhe një fotografi të gurit, sepse ende nuk i keni parë anë të rëndësishme të tij:



Fotografia 6: Gravurat dhe simbolet në Illyricum Sacrum: 1) Gushak i rendit të zgjatur; 2) Gushak i rendit të parë; 3) shkallë/cep për lidhje me pjesët tjera të objektit; 4) Lulja e Jetës me katër petale; 5) E pa njohur (vrimë për lidhjen e gurit me anë të shufrës metalike nëpërmjet "Gushakut të rendit të parë me direkun e drurit – në këtë rast drurin e bungut); 6) "Syri i Masonëve" në gjashtë këndëshin e Yllit të "Davidit"; 7) Ylli i "Davidit" (Illyricum Sacrum); 8) Pema e Jetës; 9) Lulja e Jetës me pesë petale.

Lulen e Jetës e gjeni kudo nëpër djepa të familjeve shqiptare, kryesisht me gjashtë petale, tash me siguri më rrallë, por unë e mbaj mend djepin tim dhe të tjerëve që ka pasur disa

të tilla te secili djep. Aq i shpeshtë ka qenë ky simbol në djepa sa që atëherë mendoja se përpunuesit e drurit ose prodhuesit e djepave nuk ditkan tjetër gjë pos ta vizatojnë këtë simbol. Unë (dhe disa të tjerë) e vizatoja me kompas kur isha nxënës i shkollës fillore. Së pari bëja rrethin, pastaj në formë të harqeve nxirrja një lule me gjashtë petale, e nganjëherë edhe pesë. Më dukej punë zbavitje dhe mënyrë se si për ta humbur kohën! Mos të harrojmë se gjeometria dhe astronomia në antikë kanë qenë shumë të përparuara. Nëse bëni vizatime të shumë rrathëve dhe mundoheni të nxirrni diçka duke i bashkuar pikat, u del edhe Ylli i "Davidit" sikur në fotografinë më poshtë:



Figura 1: Heksagrami dhe Lulja e Jetës të bashkuara

A po e kuptoni tash pse Lulja e Jetës dhe Ylli i "Davidit" gjenden së bashku në gurin që është gjetur në Shushicë? Pyetja është: Nga rrjedh Ylli i "Davidit" dhe çka simbolizon? Mund të gjeni përgjigje dhe interpretime deri në pakufi. Unë po ua sjelli vetëm një nga disa prej atyre që njiheshin nga ilirët (të tjerat ua siguroj më vonë pasi të marrë frymë pak nga konspiratorët!).

Çka është Illyricum Sacrum?

"Sacrum" nga gjuha latine i thonë ashtit më të madh në trupin e njeriut që gjendet në pjesën e mesme të trupit, ose pjesës që lidh trupin me këmbët. Në anatomi sot e quajmë "legeni" ose "kompliku". E ka formën e trekëndëshit dhe në formë simbolike paraqitet si trekëndësh. Me trekëndësh simbolikisht është paraqitur mashkulli, ndërsa me trekëndëshin në pozitë të kundërt femra. Kur bashkohen të dy trekëndëshet ose mashkulli dhe femra, na jep këtë figurë:



Figura 2: Ky nuk është simbol i judaizmit, e as Yll i "Davidit", por Illyricum Sacrum. **©Isa Mulaj, 2013**

Pema e Jetës mund të paraqes pemët që gjendet në vendin ku është gjetur Illyricum Sacrum. Në të vërtetë, e mbaj mend kur kam qenë fëmijë se ai vend dukej si Kopshti i Edenit! Edhe sot në atë lokalitet, ndonëse është shëmtuar shumë, ka shumë pemë, sidomos dardha.

Çfarë rëndësie ka Illiricum Sacrum për të kaluarën, të sotmen dhe të ardhmen?

Shumë:

- Lulja e Jetës është simbol mjaft i përdorur nëpër botë. Unë ua solla dëshminë nga terreni për vjetërsinë e saj;
- Gushaku përdoret praktikisht edhe sot;
- Ylli i Davidit është term i shpifur si për kah etimologjia, ashtu edhe për kah historia dhe arkeologjia. Davidi e as Sollomoni nuk kanë jetuar para 4.000 viteve;
- Pema e Jetës në Illiricum Sacrum duket sikur pendla, por në fund e ka bishtin në formë të zgjeruar që sugjeron se është pemë ose dru. Nga pendla ose *l'lendra* siç i thuhet në Dukagjin, ka rrjedhë emri *penda*, sepse pendla ose pupla e shpezëve është përdorur si mjet për të shkruar. Edhe në anglisht emri *pen* (laps) e ka burimin nga ky emër shqip.

Në bazë të të gjeturave nga Illyricum Sacrum dhe atyre që do t'i gjejmë nga dy gurët tjerë, vijmë në këtë përfundim:



Fotografia 7: Illyricum Sacrum në Flamurin e Izraelit

Fotografia 8: Illyricum Sacrum si harrni I verdhë për identifikimin e hebrenjve gjatë kohës së nazizmit



Fotografia 9: Illyricum Sacrum në kishë

Fotografia 10: Illyricum Sacrum në Vulën e Madhërishme të SHBA-së



Fotografia 10: Autori duke treguar Yllin e "Davidit" në xhaminë Sulltan Ahmet. Shikoni dritaren me grila të hekurta që përmban Lulen e Jetës (për një shikim më të qartë shikoni Fotografinë 12 më poshtë)

Fotografia 11: Autori duke bërë me gisht te struktura e rrethojës me yje të "Davidit" brenda xhamisë Sulltan Ahmet

Fotografia 12: Autori te dritarja e xhamisë Sulltan Ahmet. Në sfond, rrethoja e hekurt me Lulen e Jetës. Nuk po i bie X meqenëse qenka me 6 petale!

Fotografia 12: Autori te muret e oborrit të Aja Sofia-s në Stmaboll (gjendet përballë xhamisë së Sulltan Ahmetit) duke pozuar te Ylli i "Davidit" i shekullit XVII-të. Edhe kësaj nuk po i bie X pasi nuk i paska këndet e prera si Illyricum Sacrum!

Çka janë gjithë këta X-sa në shenjën e Yllit të "Davidit"? t'iu kërkojmë atyre që e përdorin që të heqin dorë nga ai dhe mos ta përdorin, a po? Jo, jo! Qëllimi është vetëm të dihet se nga kush është marrë dhe nga e ka origjinën, si dhe mos të pretendon ndokush se është simbol i ekskluziv i judaizmit, hebrenjve dhe Izraelit. Për kryqin pranohet se nuk është e drejtë ekskluzive ose shpikje e të krishterëve, ashtu siç pranohet edhe për yllin pesëcepësh se nuk është simbol i komunizmit dhe "swastika-n" që nuk ishte simbol ekskluziv i nazizmit por huazim. Gjersa shumë njerëz nëpër botë merren me zbërthimin dhe interpretimin e Yllit të "Davidit" dhe na tregojnë se ai gjendet i vizatuar edhe në Kinë, së paku le të na sjellin një dëshmi më origjinale dhe autentike se atje është përdorur më herët se para ilirëve. Duam ta vërtetojmë me dëshmi, e jo të merremi me mësimet e fabrikimeve ose shpikjeve që janë bërë në librat e historisë për Greqinë e lashtë. Një grup i zgjedhur i dhjetëra historianëve, antropologëve dhe ekspertë të periudhës së klasicizmit të paguar mirë dhe duke punuar shumë ka pranuar publikisht në një konferencë për shtyp më 2010 se ka bërë komplet falsifikimin e civilizimit dhe artefakteve që gjoja ka ekzistuar në Greqinë e lashtë, duke përfshirë edhe shpikjen e sistemit që sot e njohim si demokraci. Këto falsifikime janë bërë ndërmjet viteve 1971 dhe 1974. Çdo gjë ishte falsifikuar dhe zbukuruar. Këso gjëra kemi mësuar në shkolla për të marrë notë kaluese, pra gjëra të rrejshme. Profesorit Gene Haddelbury nga shef i katedrës së studimeve helenistike në Universitetin Gjorgjtaun i ishte bërë thirrje të jep dorëheqje pas pranimit të falsifikimeve të cilat as ai nuk kishte besuar do të shkojnë aq larg me trillime, deri sa ta fusnin

homoseksualitetin si kulturë në mes të ushtrisë spartane, çka e kishte detyruar atë ta braktisë grupin. A e dini se për çfarë "historia e tillë" tregon se homoseksualizmi ka qenë "civilizim" edhe në antikë, çka në fakt nuk ka qenë? Është dëshirë e homoseksualëve të sotëm, dhe kaq. Shikoni se si na kanë gënjyer rreth civilizimit në Greqinë e lashtë:



Fotografia 13: Artefakti "antik" që ruhet në Somervajll të Maseçusecit

Ky "artefakt antik" është prodhuar në vitet 1970-ta në SHBA dhe i atribuohet Greqisë së lashtë. Fotografohet dhe paraqitet në librat e historisë. Kaq. Nga fotografia në letër nuk mund ta testojmë vjetërsinë e artefaktit, por kur shkojmë dhe e testojmë me rreze të karbonit vetë artefaktin, e vërejmë se me çfarë falsifikimesh na i shërbejnë tekstet e historisë. Këtu Shoqata e Arkeologëve Evropianë duhet të jetë shumë e ashpër, e jo të dal paraprakisht me vlerësime të paralajmërimit alarmant rreth "mashtrimeve monstruoze" që paraqitkan hipotezat se në Bosnjë ekzistojnë piramida që duhet të hulumtuar në hollësi. E ftoj këtë Shoqatë të del me deklaratën se ajo që u zbulua në Shushicë nga Isa Mulaj "paraqet një mashtrim të tmerrshëm, kriminal, terrorist" apo të çfarëdoshëm!

Çka ka në rajonin ku është gjetur Illiricum Sacrum?

- Ka pasur uji, një krua i madh dhe i rrjedhshëm deri në fillim të viteve 1990-ta. Kroi përdorej për uji të pijes, ujitje, dhe larje të rrobave me ***lèsë***. Ka edhe sot uji, por gjatë verës vetëm si pus.

- Gurë tjerë të gdhendur, kryesisht në formë katrore, grumbuj gurësh, shumë prej të cilëve gjenden nën dhe, por edhe në sipërfaqe ka mjaft të tillë.
- Ka qenë objekt kulti, sipas të gjitha gjasave tempull. I mbledhim të gjithë gurët, gërmojmë edhe të tjerët (shumë janë zhdukur edhe e di ku kanë përfunduar), dhe mund ta bëjmë rikonfigurimin e mundshëm të objektit.
- ***Qereqhane***, ku duket se janë djegur një pjesë e madhe e gurëve.
- Përrocka e thellë deri në 5 metra që e ka krijuar uji i kronit.
- Pemë që ekzistojnë sot: dardha (më së shumti), qershia, ftonj, gjerenika.
- Lisa të **bungut** që për çudi nuk janë prerë edhe sot. Në përroskën që e ka formuar uji i kronit, gjendet dy shelnje të mëdha. Prania e tyre në vendin që nuk e mendon askush, i kishte lajthitur shumë Rifain&Co. duke kërkuar fshehurazi deri sa u ka dalë gjuha stomit t'prronit.
- Në lokalitet ka plepa të ngushtë që rriten gjatë duke shkuar përpjetë.
- Guri është gdhendur në vend sepse aty është terren kordinoro-shkëmbor. Nuk e kam fotografuar më qëllim një guri tjetër të mermerit nja 40 metra në shkëmb që duket i përdorur por i pagdhendur dhe gravuar.
- Ka ekzistuar çardaku i cili është djegur më 4 prill 1999 nga forcat serbe. Çardaku i njëjtë ku ka lindur Tahir Efendiu stom prronit (babai i Mehmet Akifit) ose në vend tjetër, ishte djegur më 1924 nga serbët.
- Vendi ku është gjetur Illyrucum Sacrum ose ky guri në foto, ishte pronë e vëllait të gjyshit të Tahir Efendiut.
- Dy gurë tjerë të ngjashëm gjenden në perimetër 4 kilometra, janë hedhur ose varrosur para disa viteve, por këtë nuk guxoj njëherë ta bëjë publik.
- Aty ku është gjetur guri (plus grumbujt e gurëve tjerë), në mars dilnin lule me ngjyrë të verdhë (carme) të çiltër me pesë petale dhe gjethe të gjelbra pak si me rrudha. Po e dini se për cilin lloj të luleve e kam fjalën.

Uji, pemë, gurë, dru bungu, pemë mali, dhe tokë pjellore përpara, çka tjetër u nevojiteshin banorëve të atij vendbanimi ilir. Të gjitha i kishin në një vend. Ky është një argument i fortë, a po?

Pyetjet, përgjigjet e argumentuara që do t'i gjeni në libër për Illyricum Sacrum, janë:

- Pse Ylli i Davidit në Illyricum Sacrum nuk ka të bëjë asgjë më hebrenjtë, të krishterët, dhe myslimanët?
- Kur dhe nga kanë ardhur shqiptarët e sotëm të Shushicës? Kush ishte para tyre aty?
- A është Kroni i Popit i Popit nga Kisha në Kërrsh të Vogël?
- A quhej popi Pali apo Pavli?

- Çka janë sot gjithë këto toponime mjaft të njohura: Përroska e Pa(v)lit, Roga e Pa(v)lit, Kroni i Pa(v)lit, Kërrshi i Pa(v)lit, Podi i Pa(v)lit? Kush ka qenë ky njeri kaq i njohur atëherë?
- Si është e mundur që me gurët e çfarëdoshëm dhe pa formë të kështjellës ose kishës në Kërsh të Vogël të ndërtohet xhamia ndërmjet viteve 1851-1860, e të lihen gurët e gdhendur mirë të Tempullit ose Objektit të Kultit pagan?
- Pse shqiptarët nuk e shkruajnë si duhet historinë dhe tregohen shpërfillës, shantazhues dhe pengues ndaj punës së të tjerëve?
- Pse institucionet e Kosovës i përndjekin mizorisht hulumtuesit e vërtetë me urdhër të mafisë së huaj, promovojnë llaskuçët, hajnat, akademikët dhe profesor-doktorrët me bateria të cilët më pak argumente shumëkush i qet n'kungull t'kresë?
- Pse shkenca në Kosovë është biznes kriminal e jo shkencë, dhe në funksion të zhbërjes së qenies shqiptare nëpërmjet degjenerimit?
- Pse shqiptarët në masë sot të bardhës i thonë e zezë dhe anasjelltas, të mençurit injorant e injorantit i mençur, kriminelit njeri i mirë e humanistit i marrë dhe i rrezikshëm? A po e vërtetojnë shqiptarët gjykimin e Karl Marksit se "shqiptarët janë popull grabitqar, anti-human dhe kundërshtarët më të egër të civilizimit?"

<u>Fjalorth (vetëm për tekstin që është paraqitur)</u>

Bung/u (shq.), *quercus cerris* (lat.), lloj druri nga *fagace,* i sektit *cerris* (rrjedh nga emri *qarri/s* në shqip). Duket i ngjashëm me qarrin, ka fletë të njëjta dhe dukje gatë të njëjtë me të, por dallon dukshëm nga qarri dhe është shumë më i fortë dhe cilësor. Bungun nga qarri në shikim të parë e dalloni nga lëvorja e jashtme. Qarri i madh e ka lëvoren me gurra më të mëdha, kurse vishkulli i tij kah gjysma e përpjetë deri në maje e ka lëvoren më të lëmuar se bungu.

Gushak (shq.), në përkthim të drejtpërdrejtë e ka kuptimin e gushës. Rrjedhë nga *gusha* sepse e ka formën e saj, pra në formë të kallëpit sikur në Illyricum Sacrum dhe në gushën e njeriut që është brenda nofullave. Në terminologjinë toskë përdoret edhe si *gojëza,* por realisht e kanë formën e gushës dhe jo të gojës.

Çardak (tur.), shtëpi dykatëshe e kohës otomane, ku kati i parë ishte i ndërtuar me gurë, kurse i dyti me drunj kryesisht të bungut.

Guri (shq.), material që gjendet në natyrë në formë të ngurtë. Nga ky emërtim ka rrjedhur edhe emri sllav *gora* që do të thotë *bjeshkë* ose *shkëmb,* ose edhe *mal.* Rrafshina që ka shumë gurë njihet si Podguri (rajon ndërmjet Pejës dhe Istogut), kurse në sllavisht Podgora.

Lèsë (shq.), shih *perajkë*.

Illyricum Sacrum (lat.), në përkthim të drejtpërdrejtë do të thotë *legeni/kompliku ilir* që identifikohet me ashtin më të madh në trupin e njeriut në formë të trekëndëshit. Simboli i ashtit të mashkullit është trekëndëshi në formë piramide, kurse ai i femrave trekëndësh në pozitë të kundërt, që kur bashkohen japin heksagramin që në kulturat tjera u njoh si Ylli i Davidit. Si simbol, zakonisht gjendet i shoqëruar me Lulen e Jetës dhe Pemën e Jetës dhe në kombinim me këto si tërësi njihet si *Illyricum Sacrum.*

Perajkë (shq.), vegël e punuar nga druri (më së shpeshti nga bungu) në formë katrore dhe me bisht që përdorej për larjen e rrobave duke i palosur rrobat në guri (ose objekt tjetër të pastër) dhe duke i goditur ato në gjendje të lagët me këtë vegël.

Qereqhane (sërb.), gropë e madhe që hapet për pjekjen e gurëve dhe bërjen e gëlqeres në mënyrë tradicionale me zjarr të lëndëve drusore.